

# PLANI PËR MBAJTJEN E MËSIMIT NË SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME NË VITIN SHKOLLOR 2020/2021

## DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Vendimi i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH) për rihapjen e shkollës në vitin shkollor 2020/2021 e merr parasysh faktin se shkolla është me domethënie thelbësore për arsimin dhe mirëqenien e fëmijëve dhe nxënësve

Për sjelljen e vendimeve për rihapjen e shkollave është bërë vlerësim i përgjithshëm i rreziqeve, për të cilën u morën parasysh faktorët epidemiologjikë, sistemi arsimor, sistemi shëndetësor dhe kapaciteti i shëndetësisë publike, angazhimi i komunitetit dhe kapaciteti i shtetit për mbajtjen e mbështetjes ekonomike dhe sociale për më të prekurit.

Plani i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH) për fillimin e vitit shkollor 2020/2021 bazohet në nevojën të fitohen përfitime maksimale të nxënësve, mësimdhënësit dhe të punësuarit në shkollat dhe komuniteti më i gjerë, dhe po ashtu që të mos vijë deri te përhapja e KOVID-19 në vendin tonë, duke pasur parasysh se një nga të drejtat themelore të njeriut përpos arsimit është edhe e drejta për shëndetin.

Ky plan i shpjegon hapat që duhet t'i ndërmarrin shkollat fillore dhe të mesme që t'i sigurojnë masat e nevojshme për mbrojtje dhe me atë ta ulin rrezikshmërinë e përhapjes së virusit korona (KOVID-19).

Plani për zhvillimin e mësimi për vitin shkollor 2020/2021 dhe Protokolli sigurojnë kornizë për shkollat për mënyrën si të fillojnë dhe vazhdojnë procesin arsimor në arsimin fillor dhe të mesëm. Në këtë periudhë, shkollat duhet të rregullojnë kushtet për realizimin e mësimi në përputhje me Planin dhe Protokollin në mënyrë që të sigurojnë një proces edukativo-arsimor të vazhdueshëm.

### 1. ARSIMI FILLOR

Në shkollat fillore në vitin akademik 2020/2021, procesi edukativo-arsimor realizohet në pajtim me Kalendarin për organizim dhe punën e shkollave, sipas programit mësimor të shkurtuar në pajtim me Planin mësimor për vitin shkollor 2020/2021, në një grup prej 20 nxënësve (në klasë me madhësi standarde) dhe distanca fizike ndërmjet nxënësve të paktën 1.5 metra, si dhe me respektimin e detyrueshëm të Protokollit për mësim me prani fizike.

Mësimi në arsimin fillor mund të realizohet me praninë fizike të nxënësve në shkollë ose me mësimin në distancë.

Mësimi zgjat 30 minuta në mësimin me prani fizike ose 30 minuta orë me 5 minuta kyçe për mësimin në distancë.

Në varësi të numrit të orëve me plan mësimor, rekomandohet të bashkohen orët në lëndë të caktuara mësimore (orë bllok), me prani të një mësimdhënësi të lëndës, në mënyrë që të optimizohet qëndrimi i mësimdhënësit dhe nxënësve në hapësirën.

Në shkollat fillore ku qëndrimi është i zgjatur dhe do të fillojnë me mësim me prani fizike të nxënësve, është e nevojshme i njëjti të organizohet në kuadër të kapaciteteve të hapësirave në dispozicion në shkollën dhe të realizohet me nxënës nga paralelja e njëjtë dhe nga klasa e njëjtë (pa përzierje të fëmijëve nga klasat dhe paralelet e ndryshme).

Çdo shkollë mban shënime në bazë ditore për prani të mësimdhënësve.

Realizimi i mësimi, mungesat e nxënësve regjistrohen në e-ditarin dhe në ditarin e paraleles.

Mësimdhënësit në shkollë vijnë së paku gjysmë ore para se të filloj mësimi dhe marrin pjesë në organizimin dhe zbatimin e hyrjes së nxënësve sipas orarit të orëve dhe Protokollin.

Shkollat fillore sipas mundësive hapësinore e organizojnë mësimin në ndërrime.

Nëse shkolla fillore punon në dy ndërrime, në ndërrimin e parë përfshihen nxënësit nga klasa e parë deri në të tretën, respektivisht nga klasa e parë deri në të pestën, dhe në ndërrimin e dytë përfshihen nxënësit nga klasa e gjashtë deri në të nëntën.

Secila shkollë për ardhjen dhe shkuarjen e paraleleve në dhe nga shkolla, për ndërrimet, shfrytëzimi i pushimit të madh si dhe për mësimin në distancë përgatit orar.

Shkollat e përshtatin dhe harmonizojnë rendin në shkollë me planin dhe Protokollin për mësim me prani fizike.

### **1.1. Mësimi për nxënësit në periudhën e parë të arsimit fillor (nga klasa e parë deri në të tretën)**

Për nxënësit nga klasa e parë deri në të tretën, mësimi realizohet me prani fizike në hapësirat e shkollës, me përdorimin maksimal të hapësirave dhe kapaciteteve të kuadrove në shkollë dhe me zbatim të detyrueshëm të të gjitha masave mbrojtëse epidemiologjike të vërtetuara në Protokollin për mësim me prani fizike dhe me pëlqim të prindërve/kujdestarëve të nxënësve.

Nëse prindi/kujdestari dëshiron që fëmija i tij mësimin ta ndjek me mësim në distancë, dorëzon deklaratë në shkollë që nxënësi do të ndjekë mësimin në distancë dhe do të jetë rregullisht i pranishëm në mësim në distancë, sipas orarit të orëve të paraleles.

Për nxënësit e të cilëve prindërit / kujdestarët kanë dorëzuar deklaratë në shkollë për ta ndjek mësimin në distancë, shkolla për ata nxënës organizon mësim në distancë.

Në paralelet në të cilën ka nxënës që vijojnë mësimin në distancë, mësimdhënësi sipas kushteve, mundësive dhe specifikat e njësisë mësimore në kuadër të lëndës së caktuar mësimore mund:

- përderisa mban orën t'i kyçë edhe nxënësit që ndjekin mësim në distancë (për të cilën duhet paraprakisht t'i njoftojë),
- të incizojë orën mësimore të realizuar dhe t'ua dërgojë nxënësve që ndjekin mësimin në distancë,
- të përgatitë materiale të shtypura që i marrin prindërit në bashkëpunim me mësimdhënësin/kujdestarin e klasës/asistent arsimor,
- të mbajë orë vetëm për nxënësit që ndjekin mësim nga distanca,

Në paralelet ku mësimi do të realizohet me prani fizike dhe ku numri i nxënësve është mbi 20 nxënës dhe nuk mund të sigurohet distancë fizike së paku 1.5 metra (në klasë me madhësi standarde), paralelja ndahet në dy grupe dhe mësimin mësimdhënësi e realizon në ndërrime me të dy grupet veç e veç.

Nxënësit nga klasat e ulëta të arsimit fillor duhet më shpesh të rikujtohen për masat e mbrojtjes në përputhje me Protokollin për mësim me prani fizike, duke pasur parasysh faktin se ata tani po njihen dhe prezantohen në respektim të rregullave të rregullta të shkollës. Duhet theksuar që ata nuk duhet t'i ndajnë mes veti punët e tyre (lapsa, goma, etj.) sipas rrethanave dhe se shoqërinë mund ta shprehin në mënyra të tjera të pranueshme për situatën aktuale, për shembull duke i rikujtuar njëri-tjetrit të respektojnë rregullat për mbrojtje dhe rregullat në klasë edhe me aktivitete të tjera kreative të përshtatshme nëpërmjet të cilës do të punohet në zhvillimin e ndjenjës së empatisë.

### **1.1.1. Pushim gjatë kohës së mësimit me prani fizike**

Pushimi vogël shfrytëzohet në kohëzgjatje prej 5 minuta në mes orëve dhe pushimi i madh zgjat nga 15 deri në 20 minuta, i cili është nën mbikëqyrjen e detyrueshme të kujdestarit të klasës/mësimdhënësit. Gjatë kohës së pushimeve detyrimisht të respektohet distanca fizike dhe masat për mbrojtje në pajtim me Protokollin për mësim me prani fizike, dhe është e nevojshme të zvogëlohet sa të jetë e mundur kontakti fizik midis nxënësve.

## **1.2. Mësim për nxënësit nga periudha e dytë dhe tretë të arsimit fillor (nga klasa e katërt deri në të nëntën)**

Mësimi për nxënësit nga klasa e katërt deri në të nëntën në arsimin fillor realizohet me mësim në distancë dhe me prani fizike.

### **1.2.1. Mësimi në distancë**

Mësimin në distancë, mësimdhënësit e realizojnë nga klasa në shkollë duke përdorur platformën kombëtare nga pika 3 të këtij Plani, përveç mësimdhënësve nga pika 5 e këtij Plani.

Drejtori i shkollës kujdeset për mbulim të plotë me kyçe interneti në të gjitha klasat në shkollë. Në rast të jashtëzakonshëm kur nuk ka kyçe të mirë të internetit në shkollë dhe e njëjta nuk mund të sigurohet, si dhe në kushte të shfaqjes të ndonjë të sëmurë nga virusi korona (KOVID-19) në shkollë, si dhe në përkeqësim të gjendjes epidemiologjike në komunën ose rajonin, mësimdhënësi mund t'i mbajë orët edhe prej në shtëpi, me pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e drejtorit të shkollës.

Gjatë mësimit në distancë, dita e punës së nxënësit zgjat nga 3 deri në 5 orë në ditë, në varësi të moshës së nxënësve dhe një pushim prej 10 (dhjetë) minutash pas çdo ore mësimore apo aktiviteti.

### **1.2.2. Mësim me prani fizike**

Vetëm shkollat që i plotësojnë kushtet në Protokollin për mësim me prani fizike dhe Plani, mund të kërkojnë nga themeluesi / ministria të dorëzojë kërkesë për pëlqim nga Qeveria të realizojnë mësim me prani fizike dhe për nxënësit nga klasa e katërt deri në të nëntën.

Për realizimin e mësimit me prani fizike në shkollë për nxënësit nga klasa e katërt deri në të nëntën, themeluesi respektivisht Ministria për shkollat themelues i së cilës është Qeveria, kërkon pëlqimin nga Qeveria, në mënyrë dhe procedurë të vërtetuar në pikën 6 të këtij Plani.

Për nxënësit nga klasa e katërt deri në të nëntën në shkollat ku mësimi realizohet me leje të pranishme fizike, shkolla i shfrytëzon maksimalisht kapacitetet hapësinore dhe kuadrat në shkollë dhe e zbaton Protokollin për mësim me prani fizike.

Nxënësit në mësimin me prani fizike përfshihen me pëlqim të prindit / kujdestarit.

Nëse prindi/kujdestari nuk dëshiron që fëmija i tij të ndjekë mësimin me prani fizike, dorëzon deklaratë në shkollë se nxënësi do të ndjekë mësim në distancë dhe do të jetë rregullisht i pranishëm me mësim në distancë, sipas orarit të orëve të paraleles.

Për nxënësit, prindërit / kujdestarët e të cilëve kanë dorëzuar deklaratë në shkollë për mësim në distancë, shkolla për ata nxënës organizon mësim në distancë.

Në paralelet në të cilën ka nxënës që ndjekin mësimin në distancë, mësimdhënësi sipas kushteve, mundësive dhe specifikave të njësisë mësimore në kuadër të një lënde të caktuar mësimore mund:

- përderisa mban orën t'i kyçë edhe nxënësit që ndjekin mësim në distancë (për të cilën duhet paraprakisht t'i njoftojë),
- të incizojë orën mësimore të realizuar dhe t'ua dërgojë nxënësve që ndjekin mësimin në distancë,
- të përgatitë materiale të shtypura që i marrin prindërit në bashkëpunim me mësimdhënësin/kujdestarin e klasës/ asistenti arsimor,
- të mbajë orë vetëm për nxënësit që ndjekin mësim nga distanca,

### **1.2.3. Nxënës me pengesa në shkollat fillore komunale**

Nxënësit me pengesa në paralelet nga klasa e parë deri në të tretën duhet të përfshihen në mësimin në shkollat dhe t'iu sigurohet mbështetje nga ana e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional (edukator special, psikolog, pedagog, etj.) respektivisht ekipi gjithëpërfshirës. PAI që e përpunon ekipin gjithëpërfshirës për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore duhet t'i përshtatet mënyrës së realizimit të mësimit në shkollë për ata nxënës.

Prindërit / kujdestarët e nxënësve me pengesa, kanë të drejtë të vendosin nëse fëmijët e tyre do të ndjekin mësimin me prani fizike në shkollë apo do të ndjekin mësimin në distancë - nga shtëpia.

Nxënësit me pengesa që kanë mbështetje nga asistenti personal arsimor vazhdojnë me mbështetjen e procesit arsimor të nxënësve në shkollë ose në shtëpinë e nxënësit dhe duhet të jenë në komunikim dhe koordinim të vazhdueshëm me ekipin gjithëpërfshirës në shkollë dhe prindërit.

Asistenti arsimor në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me prindin / kujdestarin dakordohen për mënyrën e mbështetjes së procesit arsimor të nxënësit.

Asistenti personal arsimor i cili përfshihet në paralelen, i përmbahet Protokollit për mësim me prani fizike, inkurajon distancën fizike midis nxënësve dhe

distancën ndërmjet mësimit dhe nxënësve dhe ndihmon në mirëmbajtjen e higjienës së nxënësve.

Shkollat që kanë teknologji ndihmëse, e lënë në dispozicion të nxënësve që kanë nevojë për të edhe në kushte shtëpiake.

#### **1.2.4. Nxënës me sëmundje të frymëmarrjes, sëmundje kronike të rralla dhe sëmundje tjera në shkollat fillore komunale**

Nxënësve që kanë vërtetim nga mjeku amë/pediatër që për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore nuk duhet të ndjekin mësimin me prani fizike ata e ndjekin mësimin në distancë.

Prindi/kujdestari në shkollë dorëzon dokumentacion mjekësor dhe vërtetim nga mjeku amë.

#### **1.2.5. Mësim në paralele të kombinuara**

Shkollat fillore që kanë paralele të kombinuara nga klasa e parë deri në të pestën, mund të realizojnë mësim me prani fizike të nxënësve përderisa kanë kushte hapësinore, pëlqim të prindërve / kujdestarëve, i plotësojnë kushtet në Protokollin dhe marrin pëlqim nga Qeveria, në procedurën e vërtetuar nga pika 6 e këtij Plani.

### **1.3. Mësim në shkollat fillore shtetërore**

Shkollat shtetërore (shkollat fillore me burim qendror, shkollat fillore me burim qendror dhe akomodim në konvikt, shkollat fillore të muzikës dhe baletit), themelues i së cilës është Qeveria, mund të realizojnë mësim me prani fizike duke respektuar masat mbrojtëse epidemiologjike në protokollin për mësim me prani fizike dhe mësim në distancë.

Përderisa këto shkolla kanë kushte hapësinore, pëlqim nga prindërit / kujdestarët dhe i plotësojnë kushtet në Protokollin, është e nevojshme të marrin pëlqimin nga Qeveria për mësim me prani fizike, në procedurën e vërtetuar nga pika 6 e këtij Plani.

Prindërit e nxënësve me pengesa, nxënësve me pengesa të akomoduar në konvikt në shkollat me burim qendror, kanë të drejtë të vendosin se fëmijët e tyre a do të ndjekin mësimin me prani fizike në shkollë, apo do jenë të akomoduar në konvikt ose do të ndjekin mësimin në distancë - nga shtëpia.

## **2. ARSIMI I MESËM**

Mësimi për nxënësve të shkollave të mesme realizohet me mësim në distancë dhe me prani fizike.

Vetëm shkollat të cilat i plotësojnë kushtet sipas Protokollit për mësim me prani fizike dhe Planit mund ta kërkojnë nga themeluesi/ Ministria, të dorëzojnë kërkesë për pëlqim nga Qeveria të realizojnë mësim me prani fizike edhe për nxënësve të shkollave të mesme.

Shkollat e mesme përpos mësimin të rregullt - lëndëve arsimore të përgjithshme organizojnë edhe mësimin për lëndë profesionale ( për arsim profesional, arsim për art, akademinë e sportit dhe gjimnazin për sport) mësim individual, mësim praktik në shkollë dhe

kompani, mësim përmes punës tek punëdhënësi, praktika feriale të organizohet me prani fizike në pajtim me Protokollet e miratuara.

Në shkollat e mesme në vitin shkollor 2020/2021 procesi edukativo - arsimor realizohet në pajtim me kalendarin për organizimin e vitin shkollor 2020/2021, sipas plan programeve të shkurtuara, në grupe nga 20 nxënës( në klasa me madhësi standard) dhe distancë fizike ndërmjet nxënësve së paku 1,5 metër si dhe me respektimin e detyrueshëm të protokollit për mësim me prani fizike.

## **2.1. Organizimi i procesit edukativo- arsimor me prani fizike**

Shkollat e mesme, sipas mundësive hapësinore, e organizojnë mësimin me një ose dy ndërrime.

Nëse shkolla fillore punon në dy ndërrime, në ndërrimin e parë përfshihen nxënësit e vitit të parë dhe dytë, ndërsa ndërrimi i dytë përfshihen nxënësit e vitit të tretë dhe katërt.

Secila shkollë për arrdhjen, shkuarjen e paraleleve në dhe nga shkolla për ndërrimet, shfrytëzimin e pushimit të gjatë si dhe mësimin në distance përgatit orar.

Mësimdhënësit në shkollë të mesme vijnë në ora 7:00 për ndërrimin e parë, përkatësisht 13:00 për ndërrimin e dytë, që të organizojnë hyrjen e nxënësve sipas orarit të shkollës.

Gjysma e paraleleve në ndërrimin e parë arrijnë në shkollë më së voni deri më ora 7:15, ndërsa gjysma e dytë më së voni deri më ora 7:30. Në ndërrimin e parë gjysma e parë e paraleles vijnë më së voni deri më ora 13:15, ndërsa pjesa e dytë më së voni deri ora 13:30.

Mësimi për ndërrimin e parë fillon në ora 7.30, përkatësisht 13:30 për ndërrimin e dytë.

Nxënësit e një paralele duhet të qëndrojnë në një hapësirë, të shmangët mësimi në kabinete.

Varësisht prej numrit të orëve sipas planit mësimor, rekomandohet bashkimi i orëve sipas lëndëve të caktuara mësimore ( orë bllok) , me praninë e një mësimdhënësit lëndor, me qëllim që të optimizohet qëndrimi i mësimdhënësit dhe nxënësve në klasë.

Kohëzgjatja e orës mësimore është 35 minuta. Pas çdo ore mësimore shfrytëzohet pushim i shkurtër prej 5 minuta, ndërsa pas orës së dytë dhe orës së tretë pushimi gjatë prej 15 minuta ku nxënësit janë në vëzhgim të udhëheqësit të klasës dhe mësimdhënësit lëndor.

Secila paralele mund të shfrytëzojë vetëm një pushim të gjatë (15 minuta) për të dalë nga klasa në përputhje me orarin e shkollës.

Gjatë pushimeve, duhet të respektohen protokollet për distancën fizike dhe masat për mbrojtje, të shmangen kontaktet fizike, në shkollat ku është e mundur të vendose lëvizje njëkahëshe ë korridore për shkak shmangies së grumbullimit të nxënësve me paralelet tjera.

Mësimdhënësit gjatë kohës së pushimeve të minimizojnë praninë fizike në zyrat e mësimdhënësve.

Të mbahet distanca fizike ndërmjet mësimdhënësve/ punonjësve tjetër në shkollë, mësimdhënës /nxënës dhe mësimdhënës prind/kujdestar të nxënësive sipas protokolleve.

Është e obligueshme mbajtja e maskës mbrojtëse/mbulesës së fytyrës nga ana e nxënësve dhe punonjësve gjatë qëndrimit në shkollë, përveç kur janë në natyrë në oborrin e shkollës dhe nëse është e mundur mbajtja e distancës së rekomanduar.

Çdo shkollë mban shënime ditore për praninë e mësimit dhe nxënësve.

Shkollat e përshtatin dhe harmonizojnë mbajtjen e rendit në shkollë sipas Planit dhe Protokollit për mësim me prani fizike.

### **2.1.1. Nxënësit me sëmundje të frymarrjes, sëmundje kronike dhe sëmundje të rralla në shkollat fillore komunale**

Nxënësit të cilët posedojnë vërtetim nga mjeku amë/ pediatri për shkak të gjendjes shëndetësore nuk duhet të ndjekim mësimin me prani fizike por mësimin duhet ta ndjekin nga distanca.

Prindi/ kujdestari në shkollë dorëzon dokumentacion mjeksësor dhe vërtetim nga mjeku amë.

## **2.2. Mësimi në distancë**

Shkolla e cila në pajtim me gjendjen epidemiologjike në komunë/regjion dhe e cila nuk i plotëson kushtet për realizimin e procesit mësimor me prezencë fizike në shkollë në pajtim me Protokollin, procesin mësimor e realizon me mësim nga distanca.

Për procesin mësimor me mësim nga distanca përdoret platforma nacionale për mësim nga distanca e përshkruar në pikën 3 të këtij Plani.

Mësimi nga distanca realizohet sipas orarit të paraprakisht të pregaditur në orë, ora zgjat 35 minuta dhe 5 minuta për kyqje.

Orari i orëve patjetër të publikohet në ueb – faqen e shkollës, platformës nacionale i dorëzohet në mënyrë elektronike inspektoratit shtetëror arsimor.

Procesi mësimor me distancë, mësimit dhe realizojnë nga klasa e shkollës duke shfrytëzuar platformën nacionale nga pika 3 e këtij Plani, përveç për mësimit nga pika 5 të këtij Plani.

Drejtori i shkollës kujdeset për përfaqësim të tërësishëm me kyqjen e internetit në të gjitha klasat e shkollës. Në rast të mospasjes kyqje të internetit të mirë në shkollë dhe e njëjta mund të sigurohet, në kushte të paraqitjes së ndonjë të sëmurit nga virusi korona (KOVID-19) në shkollë, edhe gjatë përkeqësimit të gjendjes epidemiologjike në komunën ose rajonin, mësimit orët i mban edhe nga shtëpia pasi paraprakisht merr pëlqim nga drejtori i shkollës.

Mësimit lëndor me kërkesë të drejtorit i parashtron link për kyqje të platformës elektronike interaktive për mësim nga largësia që ta përcjellë punën e mësimit gjatë orës mësimore.

Gjatë realizimit të mësimit të lëndëve profesionale si dhe mësimit praktik në shkollimin e mesëm profesional duhet të respektohen këshillat praktike të cilat janë pjesë e Drejtimeve për realizimin e mësimit nga largësia në shkollimin profesional dhe trajnim. (<http://csoo.edu.mk/izvestuvanje/upatstvo-za-dalechsko-uchenje/>).

Mënyra e realizimit të trajnimit praktik / shkollim praktik (UPR, praktika feriale dhe mësimit praktik) është përshkruar në Drejtimit për realizimin e trajnimit praktik dhe mësimit nëpërmjet punës gjatë kohës së pandemisë e shkaktuar nga korona virusi KOVID-19 (<http://www.csoo.edu.mk/>).

Organizimi i procesit mësimorë nëpërmjet mësimit nga largësia mund të zhvillohet në periudhë të caktuar (më shkurt apo më gjatë varësisht nga gjendja epidemiologjike), dhe nëse gjendja e kërkon atë të jetë gjatë tërë vitit mësimorë.

### **2.3. Realizimi i procesit mësimorë**

Mësimdhënësi në pajtim me kushtet, mundësitë dhe specifikat e njësisë mësimore në suaza të lëndës mësimore të caktuar gjatë kohës së realizimit të orës në mësonjëtoje mund:

- ti kyçë edhe nxënësit që janë në shtëpi (duhet ti paranojtoj),
- ta incizon orën e realizuar mësimore dhe të ua dërgon nxënësve që janë në shtëpi,
- të mbajë orë vetëm me nxënësit që janë në shtëpi,
- të iu dërgon nxënësve video-orë adekuate.

Mësimdhënësi lëndor mban evidencë për realizimin e orës mësimore dhe për rregullshmërinë e secilit nxënësi dhe të njëjtit i evidenton në ditarin e punës së paraleles dhe në e-ditarin.

Për nxënësit të cilët për shkaqe të arsyeshme, me dëshmi të parashtruar apo deklarata nga prindërit / kujdestari, nuk kanë mundësi ta përcjellin mësimin me prezencë fizike në shkollë, shkolla organizon mësim nga largësia për ata nxënës.

Nxënësit që kanë vërtetim nga mjeku amë / pediatër se për shkak gjendjes së tyre shëndetësore nuk duhet të vijojnë mësim me prezencë fizike përcjellin mësim nga largësia.

Prindi / kujdestari në shkollë parashtron dokumentacion mjekësor dhe vërtetim nga mjeku amë.



### **2.3.1 Mësim në shkollat e mesme shtetërore për nxënës për nevoja të posaçme arsimore.**

Në shkollat e mesme shtetërore për nxënësit me nevoja të posaçme arsimore, përveç rekomandimeve për distancë fizike dhe mbajtje të higjienës personale, zbatohen edhe planet e veçanta të përgatitura nga ana e secilës shkollë dhe të lejuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Orën mësimore mësimdhënësi e realizon në bazë të IOP të përgatitur sipas aftësive dhe mundësive të nxënësve. Mësimdhënësi me secilin nxënës punon individualisht në pajtim me orarin paraprakisht të përgatitur.

Asistenti personal apo edukativ kyçet në paralele, duke i respektuar rekomandimet për distancë fizike dhe mirëmbajtje të higjienës personale, nxit distancë fizike ndërmjet nxënësve dhe nxënësve e arsimtarëve dhe ndihmon në mirëmbajtjen e higjienës së tërësishme.

### **2.3.2 Mësimi në shkollat e mesme për shkollim arti, gjimnaz sportiv apo akademi sportive**

Në shkollat e mesme ku mësimi realizohet për shkollim arti, gjimnaz sportiv apo akademi sportive, mësimi në lëndët për shkollim të përgjithshëm realizohen me mësim nga largësia. Shkollimi në lëndët profesionale për llojin përkatës të shkollimit realizohet në pajtim me protokollin për zbatueshmëri në shkollat e mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut për realizim të procesit edukativo-arsimor me prezencë fizike të nxënësve në vitin shkollor 2020-2021 dhe protokollet individuale të çdo shkolle. Në akademinë sportive mësimi në lëndët profesionale do të realizohet në pajtim me protokollet e lejuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut të përgatitura nga akademia në bashkëpunim me federatat nacionale të sportit përkatës.

### **2.3.3 Mësim në shkollimin dual**

Në shkollat të cilët kanë paralele ku mësimi zhvillohet në formë duale, pjesa praktike e mësimi, në kompanitë, zhvillohet me prezencë fizike në vendin e punës, duke i respektuar protokollet e përgjithshme për mbrojtje dhe protokollet e kompanive ku zhvillohet mësimi praktik.

### **2.3.4. Shkollim profesional dhe mësim nëpërmjet praktikës feriale dhe mësim nëpërmjet punës**

Praktika feriale dhe mësimi nëpërmjet punës te punëdhënësi realizohet me prezencë fizike në kompani / punëdhënës në pajtim me Udhëzimin për praktikë feriale të sjellur nga Qendra për Shkollim Profesional dhe Trajnim.

Shkollat e mesme ku realizohet mësimi profesional dhe trajnimi, mësimin praktik e realizojnë me prezencë fizike të nxënësve në shkollë në kabinete, punëtori shkollorë, laboratorit dhe hapësira të tjera të posaçme për këtë qëllim.

Shkollat e mesme profesionale për realizim të suksesshëm të praktikës feriale dhe mësimi praktik i respektojnë të gjithë protokollet e sigurisë, si dhe protokollet për veprim në shkollat e mesme në të cilat realizohet shkollim profesional dhe trajnim në republikën e

Maqedonisë së Veriut për zbatim të mësimit praktik me prezencë fizike të nxënësve në vitin shkollor 2020/2021, protokoli i përgjithshëm për masa preventive gjatë realizimit të mësimit nëpërmjet punës, praktikës feriale trajnimit praktik dhe ushtrime të nxënësve të punëdhënësi si dhe protokollet për masa preventive gjatë realizimit të mësimit nëpërmjet punës, praktikës feriale, trajnimit praktik dhe ushtrimet e nxënësve të punëdhënësi në sektorin e makinerisë, sektorin e bujqësisë, peshkatarisë dhe veterinarisë, sektorin e kimisë dhe teknologjisë dhe sektorin e shërbimeve personale.

### **3. PLATFORMA NACIONALE E MËSIMIT NË DISTANCË PËR SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME**

Për nxënësit që do t'i bashkohen mësimit në distancë, mësimitdhënësit e përdorin platformën nacionale të mësimit në largësi që mundëson ndërveprim dhe komunikim të dyanshëm midis mësimitdhënësit dhe nxënësit.

Gjatë vitit shkollor, mbështetet bashkëpunimi midis mësimitdhënësve për ndarjen reciproke të materialeve dhe detyrave. Ndarja e materialeve në të cilat të gjithë mësimitdhënësit do të kenë qasje është nëpërmjet incizimit të video-mësimeve në pajtim me programin mësimor të bashkangjitur në platformën nacionale ose EDUINO.

Platforma nacionale e mësimit në distancë do të mundësojë organizimin e përmbajtjeve në formën e e-Klasës. Secila e-Klasë është e lidhur me mësimitdhënësin përkatës dhe nxënësin, me ç'rast mësimitdhënësi e ka mundësinë:

- t'i përcaktojë përmbajtjet (dokumentet, prezantimet)
- t'i lidh përmbajtjet e jashtme nga EDUINO
- t'u dërgojë njoftime nxënësve
- të kryejë komunikim të dyanshëm duke i përdorur forumet
- të përcaktojë aktivitete që duhet t'i bëjnë nxënësit
- të japë informata kthyesë për detyrat e shtëpisë të paraqitura nga nxënësit
- të mbajë mësim on-llajn me ndihmën e Microsoft Teams
- të krijojë dhe mirëmbajë teste
- të krijojë e-mësime

Platforma nacionale mundëson realizimin e testeve on-llajn, të cilat mund të bazohen në bankat e pyetjeve. Bankat e pyetjeve fillimisht do të jenë lokale për secilën lëndë, me mundësinë për të ndarë në të ardhmen. Bankat e pyetjeve mund të përmbajnë pyetje të llojeve si në vijim:

- Pyetje të eseve

- Përgjigje të shkurtra
- Zgjedhja e një përgjigjeje të saktë
- Zgjedhja e më shumë përgjigjeve të sakta
- Plotësimi i vendeve të zbrazëta të fjalive
- Pyetjet matematikore, përgjigjja e të cilave është formulë e thjeshtë
- dhe lloje të tjera të pyetjeve që do të ofrohen nëse është e nevojshme.

Platforma nacionale do të mundësojë ndjekjen e hollësishme të aktiviteteve të mësimdhënësve dhe nxënësve, për të cilat mund të përgatiten raportet.

#### **4. KONTROLLI (VËRTETIMI) I NJOHURIVE TË NXËNËSVE NË SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME**

Kontrolli (vërtetimi) i njohurive të nxënësve realizohet nga prania fizike në shkollë, në çdo tre muaj sipas orarit të caktuar paraprakisht të paraleleve, numrit të nxënësve në paralele dhe kohëzgjatjes së kontrollit, për çka Byroja për Zhvillimin e Arsimit dhe Qendra e Arsimit dhe Trajnimit Profesional do të përgatisin udhëzues të veçantë për kryerjen e kontrollit të njohurive të nxënësve.

Në rast të përkeqësimit të gjendjes epidemiologjike, kontrollimi i arritjeve të nxënësve mund të kryhet edhe pa prani fizike të nxënësve, ndërsa shkollat fillore dhe të mesme kontrollimin e arritjeve të nxënësve e zbatojnë në pajtim me udhëzimet për zbatimin e kontrollimit të arritjeve të suksesit të nxënësve pa prani fizike, të përgatitura nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit dhe Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim.

Pas përfundimit të procesit të kontrollit të njohurive të nxënësve, kujdestari i klasës e informon në formë elektronike prindin për suksesin e arritur të fëmijës së tij, të përcaktuar nga Këshilli i Klasës dhe Këshilli i Mësimdhënësve.

Nëse nxënësi që ndjek mësimin në largësi nuk përfshihet në mësim për më shumë se pesë ditë, mësimdhënësi me shërbimin profesional në shkollë e viziton nxënësin në shtëpinë e tij dhe zhvillon bisedë me prindin në lidhje me ndjekjen e detyrueshme dhe të rregullt të mësimin.

Në lidhje me vizitën dhe bisedën e bërë me prindin / kujdestarin përpilohet një shënim.

Për praninë e parregullt në mësim zbatohen masat pedagogjike të përcaktuara në Ligjin për arsimin fillor dhe Ligjin për arsimin e mesëm.

Nxënësi i cili nuk mund të vlerësohet me notë për shkak të mungesës në të paktën një të tretën e fondit të orëve mësimore në lëndë të caktuara, ka të drejtë të japë provim të klasës / provim të vitit në lëndët në të cilat nuk ka notë, në pajtim me Ligjin për arsimin fillor / Ligjin për arsimin e mesëm.

#### **5. TË PUNËSUARIT NË SHKOLLA ME SËMUNDJE KRONIKE DHE/OSE SËMUNDJE TË RRALLË**

Punonjësit në shkollat që janë të liruar nga puna bazuar në listën e përcaktuar të sëmundjeve kronike nga Ministria e Shëndetësisë, vazhdojnë me punë në vendet e tyre të punës dhe kryejnë rregullisht detyrat e tyre të punës.

Të përjashtuar janë personat (pacientët) tek të cilët sëmundja është në fazën e përkeqësimit dhe për ato me sëmundje malinje, për të cilët do të jepet vërtetim me diagnozë dhe mendim të mjekut specialist, në bazë të së cilës vërtetohet se këta persona do të shfrytëzojnë pushim mjekësor.

## **6. PROCEDURA PËR MIRATIMIN E MËSIMIT ME PRANINË FIZIKE PËR SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME**

Shkolla fillore komunale, përkatësisht shkolla e mesme, kërkesën për mësim me prani fizike (për nxënësit nga klasa e katërt deri në klasën e nëntë dhe për nxënësit në shkollat rajonale në paralele të kombinuara nga klasa e parë deri në klasën e pestë) me arsyetim për plotësimin e kushteve dhe kriterëve nga Plani dhe Protokollin, e dorëzon te themeluesi, ndërsa ai më së voni deri në datën 10 të muajit rrjedhës e dërgon te Komisioni i formuar nga Qeveria për shqyrtimin e kërkesave të paraqitura për organizimin e mësimit me prani fizike.

Shkollat shtetërore (shkollat fillore me burim qendror, shkollat fillore me burim qendror dhe akomodim në konvikt, shkollat fillore të muzikës dhe baletit, shkollat e mesme artistike, akademia sportive, shkolla e mesme sportive dhe shkollat e mesme për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore), themeluesi i të cilave është Qeveria, për shkak të aktivitetit specifik edukativo-arsimor që kryejnë, mënyrën e realizimit të mësimit e përcaktojnë me Propozim-plan dhe Protokollin i cili është në përputhje me Protokollin për mësim me prani fizike dhe e dorëzojnë në Ministri, ndërsa kjo më së voni deri në datën 10 të muajit rrjedhës e dorëzon në Komisionin e formuar nga Qeveria për shqyrtim të kërkesave të paraqitura për organizimin e mësimit me prani fizike.

Komisioni në afat prej 7 (shtatë) ditësh, në bazë të përmbushjes së kriterëve dhe kushteve, në përputhje me protokollin për llojin e duhur të shkollës, dorëzon propozim në Qeveri për dhënien e pëlqimit për organizimin e mësimit me prani fizike të nxënësve në shkollë.

## **7. NXËNËSIT TË CILËT NUK KANË TIK / SMARTFON OSE INTERNET**

Për nxënësit që nuk kanë qasje në TIK ose internet, shkolla organizon mësim me prani fizike në shkollë, me pëlqimin e prindërve / kujdestarëve dhe pëlqimin ekskluziv të Qeverisë në procedurën e përcaktuar nga pika 6 e këtij Plani.

Nëse prindërit nuk bien dakord që mësimi të realizohet me prani fizike, shkolla përgatit materiale të shtypura që merren nga prindërit në bashkëpunim me mësimdhënësin / kujdestarin e klasës / asistentin arsimor. Përveç kësaj, në interes të fëmijëve, shkolla në marrëveshje me prindërit bien dakord për mënyrën më të sigurt për të dhënë dhe për të marrë materialet mësimore, detyrat e shtëpisë dhe obligimet e tjera shkollore për nxënësit.

## **8. MBIKËQYRJA PËR ZBATIMIN E PLANIT DHE PROTOKOLLEVE**

Ndjekjen e realizimit të procesit mësimor në përputhje me Planin dhe Protokollin (me prani fizike të nxënësve dhe mësim në largësi), e kryen Inspektorati Shtetëror i Arsimit në përputhje me kompetencat e tij përmes mbikëqyrjes së rregullt dhe të jashtëzakonshme,

ndërsa mbikëqyrje të zbatimit të Protokolleve për mbajtjen e mësimit me prani fizike në vitin shkollor 2020/2021 kryen Inspektorati Shtetëror i Arsimit dhe Inspektorati Sanitar Shtetëror në përputhje me kompetencat e tyre.